

INTERVISTË ME SELIM KRASNIQIN

Prishtinë | Data: 18 shkurt, 2025

Kohëzgjatja: 46 minuta

Të pranishëm:

- Selim Krasniqi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Selim, a mundeni me na tregu diçka për prejardhjen e juaj, familjen kujtimet e para?

Selim Krasniqi: Unë jam i lindur në Junik në komunën e tashme të re e cila ka qenë komunë deri në vitin '61. Pas vitit 1961 veç ka marrë komunë të Deçanit dhe pastaj në vitin 2000 e kemi rikthyer prap. Mësimet e para i kam bërë aty në fillore, ku kom pasë fatin që t'kem mësues jashtëzakonisht t'mirë. Do t'i përmendi nja tre prej tyre. Mësuja tim nga klasa e dytë deri në të pestën Halil Balen. Punëtorin e Institutit Albanologjik Ibrahim Koqin. Profesorin Zenun Gjoqi, profesor i gjuhës e në veçanti do ta kisha përmend profesorin e biologjisë Ismet Bajraktarin që ka qenë profesori i parë i gjenetikës në viset shqiptare.

Kurse shkollën e mesme kam mbaruar në Deçan. Filloren në vitet '70-të. Pikërisht në vitin kur osht' hapë Universiteti i Prishtinës. Mësimet e mesme i kam bërë në Deçan në vitin '74. Nga viti '74 jom regjistru në Fakultetin e atëherëshëm Filozofik në Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe kam mbaruar në afat në vitin 1978. Pastaj studimet pasuniversitare. Kam regjistru në fushën e morfo-sintaksë, morfologji dhe sintaksë. Kam filluar të punoj nga viti 1978 kur isha student në semestrin e tetë në Shkollën Fillore Elena Gjika dhe Naim Frashëri.

Pastaj në janar '79 jam pranuar në Gjimnazin e sotshëm Sami Frashëri. I cili e kishte atë emër nga viti '49 por në vitet e '50-ta regjimi serb i ndërroj emrin Ivo Lola Ribar dhe pastaj është rikthyer nga viti 1991 në emrin Sami Frashëri. Nga gjimnazi Sami Frashëri kem pasur paralele në Fushë Kosovë. Për shkak të udhëtimit nga viti '80-të e deri në pensionin në vitin 2020, kam punuar në Gjimnazin Hyvzi Sylejmani të Fushë Kosovës.

Anita Susuri: Po du pak me u kthyer me u ndalë në do etapa që i përmende. Ma së pari për shkollimin si fmi kur keni qenë, sa ka qenë e vështirë se kanë qenë edhe vitet që koha e Rankoviçit, fundi i Rankoviçit po m'duket, ka qenë ni periudhë pak ma e vështirë historike për shqiptarët. Po qysh e kujtoni ju? A ka ndiku te pjesa ku keni jetu?

Selim Krasniqi: Në shkollën fillore ajo s'ka ndiku shumë për arsye se atëherë vetëm kemi pasur mbi 90% mësues shqiptarë, mësues jo shqiptar kemi pasë vetëm gjuhen serbe. Që fatkeqësisht asnjëri prej

nesh që kemi mbaru mësimet e para, mësimet e mesme s’kemi mundur ta mësojmë asnjë fjali. Sepse asnjë prej tyre diçka tjetër s’ta ka dhënë të mësojnë por vetëm ndonjë vjershë përmendësh. Qëllimi i tyre dihej që t’na lënë pa ditur gjuhën.

Gjuhën serbo-kroate në atë kohë ne nga rrethi ynë shumë pak e kemi ditur. Atë e kemi mësu nga literatura në studime nga viti ‘74-’78, meqenëse kishim provim edhe në letërsi botërore edhe jugosllave. Literatura nuk ishte në gjuhën shqipe, lexonim edhe në serbisht edhe në kroatisht me ndihmën e fjalorëve. Fatkeqësi e madhe ka qenë se në atë kohë nuk mësohej ndonjë gjuhë tjetër, vetëm gjuha ruse.

Anita Susuri: A keni mësu ju rusisht?

Selim Krasniqi: Kemi mësu rusisht. Shkrim, lexim, përkthim asniherë sepse kryesisht na kanë dhënë mesuesit serb.

Anita Susuri: Shkolla a ka qenë në vendin ku keni jetu a ka qenë ma larg?

Selim Krasniqi: Shkolla ka qenë në vendlindje. Kemi pasë shumë afër. Mësuesit i kemi pasë vendas. Ni pjesë kanë qenë të ngritur profesionalisht. Unë që veçova për shembull do ta përmend mësuesin tim nga klasa e katërt dhe e pestë Ibrahim Koqin që ishte punëtor më vonë i Instituti Albanologjik. Atëherë ne fëmijëve si dhurata na jepshin libra vizatimor. Niherë po i thom mësuesit, “Mu ma ke dhanë Antigonën e Sofokliut kurse të tjerët kanë marrë maçorrin me qizme”, tha, “Unë di kujt i jap çka dhe të lexoni”. Porosia e tij ka qenë që të njohim të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe.

Fatkeqësisht atë e kom pasur deri në vitin 1998, ni bibliotekë plot mbi pesë mijë libra ekzemplarë dhe të gjitha janë djegur në Junik. Juniku gjatë luftës është djegur dhe shkatërruar tërësisht. Fatkeqësisht edhe kullat që kanë mbetur dy-tri të cilat kanë filluar të rindërtohen vetëm pas vitit 2000.

Anita Susuri: Po më intereson pak edhe për familjen e juj, me çka janë marrë prindërit?

Selim Krasniqi: Po kryesisht familjet tona kanë qenë familje që janë marrë vetëm me bujqësi, me diçka tjetër s’janë marrë. Baba ka ditë shkrim lexim, nana jo. Po përmendi që në vitet ‘70-të për afërsisht në Kosovë kanë qenë afër 60% së paku analfabet që s’kanë ditur shkrim lexim. Kanë marrë hov ma të madh sidomos nga viti ‘70 deri në vitin ‘81 kemi arritur që në vitin ‘81 nëse s’gaboje ka pasur vetëm Universiteti i Prishtinës mbi 30 mijë student, të rregulltë. Pesë ose gjashtë mijë student me korrespondencë. Profesorët të gjithë kanë qenë jashtëzakonisht t’mirë, punëtor, pedagog, mësimdhënës që meritojnë të përmenden.

Unë do t'i përmendja akademikët, profesor Ajetin, profesor Besim Bokshi, profesor Ismajlin, prof Latif Mulakun dhe sidomos profesorin Latif Berisha i cili u vra në vitin 1999. Menjëherë pas bombardimeve të NATO-s në vendlindjen e tij në Smrekonicë bashkë me shumë intelektual të tjerë.

Anita Susuri: Në familje te ju a keni qenë shumë fmi, a keni pasë përkrahje për shembull prej...

Selim Krasniqi: Po kryesisht në familje fshatare të gjithë kemi qenë tetë-dhjetë apo 12 fëmijë. Ne kemi qenë tetë fëmijë. Babai është përpjekë me punët e shtëpisë, me punët bujqësore që t'na shkolloj. Po duhet përmendur që ne atëherë nga shkolla fillore, nga klasa e tetë dhe tutje kemi punu edhe punë vetë. Me grumbullimin e gështenjave, boronicave në bjeshkë, qershizave. Me ato bile së paku veshmbathejn edhe disa të holla për shkollim i kemi siguruar vet. Studimet dihet kemi marrë bursa.

Anita Susuri: E shkollën e mesme thatë që e keni përfundu...

Selim Krasniqi: Në Deçan, shkollën e mesme në Deçan. Se ni vjet pas meje do të thotë në vitin '75 janë hapë paralelet në Junik kurse unë e kam mbaruar në Deçan. Dihet, atëherë të gjithë kemi udhëtuar me një autobus ku osht' nisur nga vendlindja në orën pesë. Pritshim së paku ni orë në lokalet e gjimnazit. Për arsye se autobusët rrugët jo me rregull, ishin të pa asfaltuara. Po duhet të përmendet që Juniku ka pasë rrugë të asfaltuara nga viti 1977 si dhe ujësjellësin. Në krahasim me viset e tjera ka qenë mjaft i zhvilluar dhe intelektual mjaftueshëm për kohën.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për këtë periudhën e shkollës së mesme, për jetën kulturore shoqërore si ka qenë? A ka pasë ngjarje? Orë letrare ose diçka?

Selim Krasniqi: Po në shkollën e mesme ka qenë karakteristikë që ka funksionu mjaft mirë grupi letrat, grupi vegjitorëve, grupi dramatik. Kemi pasë shoqëri edhe në Junik edhe në Deçan ku nxënësit tonë kanë marrë pjesë edhe në gara republikane dhe atëherë federative.

Anita Susuri: A ju kujtohet diçka për shembull?

Selim Krasniqi: Po, në grupin e recitatorëve kam qenë edhe vet edhe në shkollën fillore edhe në shkollën e mesme.

Anita Susuri: Mirë. E për fakultet keni ardhë në Prishtinë pastaj?

Selim Krasniqi: Në Prishtinë në vitin 1974 nga tetori i 1974 dhe ne që kishim mbi 80 kilometra që udhëtonim na shpërndanin konvitet. Kam banuar për katër vite në konvikt. Kushtet kanë qenë të mira për kohën tonë kanë qenë të mira. Nuk kemi pasë ndonjë ankesë. Unë mund të thom që nga vitet '74 deri në vitet '80-të, mund t'i quaj vite të arta pas ndryshimeve kushtetuese që janë bërë në vitin '74. Në fakultet kemi pasë grupin Jeronim De Rada ku kam qenë anëtarë kurse nga viti '76-'77 dhe '78 e kam

udhëhequr vet, kam qenë kryetar i grupit letrat Jeronim De Rada. Ku i kemi shëtitur të gjitha viset e Kosovës po atëherë edhe në ish federatën jugosllave. Ku kishim student shqiptarë në përpjekje në Beograd, në Shkëndijë në Zagreb, pastaj në Bosnje.

Shoqëria ka qenë kulturore Lulëzimi dhe Bajram Curri. Ku merrnin pjesë me krijimet tona, i lexonim dhe i botonim edhe në revista. Jo vetëm në Kosovë por edhe në Bosnje, ish Bosnjen dhe Hercegovinën e atëherëshme por edhe në Zagreb Kroaci. Pastaj merrnim pjesë edhe në organizata siç i quanin filizofiada ku kemi marrë pjesë dy vjet rresht në Poreç të Kroacisë të sotme.

Anita Susuri: Domethanë ka qenë fillimi kur në të '70-tën është hapë Universiteti i Prishtinës, a ka pasë shumë studenta? A ka pasë profesor edhe prej Shqipërisë? Qysh ka qenë atmosfera?

Selim Krasniqi: Po në vitin '74 kemi pasë kryesisht profesor nga Kosova. Nga viti '78 kanë ardhë të ligjërojnë edhe profesor nga Shqipëria. Kurse studimet postuniversitare kanë filluar ni pjesë e madhe e profesorëve nga Shqipëria. Unë mbaj mend akademikun Majram Domi i cili vinte shpesh na mbante ligjeratë nga fusha e sintaksës. Profesorin e ndërë Tafil Kelmendi i cili ishte doktorant. Shpesh na tregonte që, "Ne", thotë, "fshehurazi japim libra në gjuhën frënge, gjuhën angleze sepse ata", thotë, "e kishin të ndaluar të lexonin literaturë tjetër përveç gjuhës ruse". Kjo tregon që ishte ni diktaturë edhe andej edhe këndej.

Ne e kishim atë elanin që t'punohet e ta shikojmë me kohën e sotshme, ju e di që do t'pyesni, atëherë ka qenë për ne ma vështirë sepse ne detyroheshim të shikonim nëpër Arkivën e Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare ta gjenim literaturën. Sot studentët tanë, nxënësit tanë e kanë shumë ma lehtë sepse mund të gjejnë përmes mjeteve teknologjike gjithë literaturën dhe kohën e fundit që është AI, Inteligjenca Artificiale.

Anita Susuri: Po. E po m'intereson tash pak për jetën si student ktu kur keni ardhë në Prishtinë. Si ka qenë Prishtina për juve? Qytet pak ma i madh se Deçani dhe Juniku.

Selim Krasniqi: Po për ne ishte mjaft ni qytet i mirë. Të gjithë e quanin student i rinisë, qytet i studentëve. Për shembull, ndonjëherë kur vinim vikendeve korzo e Prishtinës që bubuzhinte nga numri i madh i studentëve, ishte i qetë. Pothuajse s'kishte lëvizje fare. Kjo tregon se Prishtina ka qenë ni metropol që është edhe sot. Atëherë nuk kishte ndonjë, kishin filluar lëvizjet nga pak të studentëve nga viti '74-'75. Asni student nuk ishte i kënaqur me regjimin që padyshim të gjithë ishin nën përcjellje. Por, puna ishte mjaft e mirë. Studentët punonin me aq mundësi sa kishin.

Anita Susuri: E po më intereson pak edhe për çka për shembull çfarë landë ka pasë atëherë. Sa ka ndryshu sot në drejtimin e juv?

Selim Krasniqi: Në drejtimin tonë nuk kom ndëgju që ka ndryshim aq të madh nga vitet e '80-ta. Me ndonjë ndryshim të vogël që tash është bërë ndonjë landë zgjedhore integrimet evropiane, ballkanistika. Atëherë për shembull e kishim shënime, vepra shumë të Qabej që është marrë me letërsinë evropiane. Që sipas mendimit tim ende është e patejkalueshme në fushën e albanologjisë.

Anita Susuri: E më thatë që në herë të parë keni fillu punën në vitin...

Selim Krasniqi: '78.

Anita Susuri: Si ka qenë kjo?

Selim Krasniqi: Po viti '78 si student konkurova në Shkollën Elena Gjika dhe më pranuan. Ish punë jashtëzakonisht e mirë, e lehtë për neve sepse ishim të ri. 22-tat. Secili punon me vullnet. Por, edhe atëherë vërehej që nxënësit kërkonin ma shumë sesa duhet. Ndoshta edhe sesa sot. Atëherë e vetmja mundësi ka qenë e nxanësit që ligjeratat e mësimdhënësve, të prindërve. Nuk kishte mundësi diçka literaturë tjetër veç veprat që ishin të botuara në atë kohë. Për disa landë, për shembull, të shkencave të natyrës nuk ka pasë, shkencave mjekësore nuk ka pasë shqipe, prindërit është dashur t'ua lexojnë në gjuhë të tjera.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë me gjetë libra?

Selim Krasniqi: Po biblioteka jonë atëherë e krahinores së Republikës së Kosovës, Pjetër Bogdani ka pasë literaturë të mjaftueshme për ne. Fatmirësisht bibliotikistët tanë na pritshin mirë, na gjenin ato, na siguronin vendin dhe kaq. Qetësia ka qenë në nivel.

Anita Susuri: Domethanë ka funksionu, ka qenë e mbushur?

Selim Krasniqi: E mbushur me student që nëse nuk shkonim në mëngjes prej orës 07:00 deri në 08:00 nuk ka pasur ndonjë karrigë të zbrasët. Je detyru të kthehesh në banesë, në konvikt apo në ndonjë sallë tjetër të leximit që i kërkonin fakultet tjera. Shkolla e lartë pedagogjike atëherë dhe fakulteti juridik.

Anita Susuri: Po më intereson tash edhe kjo pjesa e demonstratave në vitin '81...

Selim Krasniqi: Në vitin '81 veç unë kam qenë n'punë e dijmë që në gjimnazin e Fushë Kosovës kur udhëtonim nga Prishtina atje udhëtonim edhe në këmbë. Sepse policia serbe që kishin ardhë nga Jugu i Serbisë sidomos nga Leskovci disa herë kishim edhe malltretime. Por mësimi është mbajtur në nivel. Pavarësisht nga ajo mësimi është mbajtur. Arsyeja ka qenë se planprogramet e atëhershme, pasi pyete për vitin '80-të, nga viti '81 e tutje filloj që të ndryshoj plani mësimor i gjuhës shqipe. Bije fjala e

kishim në program që ta mësonim edhe nobelistin, çmimin nobel Ivo Andriç, që ka bërë elaboratin për zhdukej ne popullit shqiptar.

Por, shumica e mësimdhënësve të gjuhës në vend të Ivo Andriçit Kadare veç ish hequr nga plani mësimor. Në ditar jemi detyruar ta shkruajmë emrin dhe mbiemrin dhe nxanësve t’ju thonim, “E kemi në plan por ju duhet ta lexoni Kadarenë”. Fatmirësisht asnjë nxënës i yni nuk ka treguar se çka shkruhet në ditar apo diçka tjetër. Ka ndodhë ndonji që nuk e ka lexuar por kur ndëgjonin që është larguar nga plani mësimor, lexonin edhe ma shumë. Por unë kam kërku nga nxënësit lekturat. Jo që t’flasin për përmbajtjen e veprës po kryesisht i kam kushtuar kujdes që ai ta lexon veprën dhe të ndalet në pjesën që e ka kuptu ai ma së tepërmi.

Unë nuk kam hasë ndonjë që ka ditë çdo detaj. Por mjafton që ai e ka kuptu veprën. Për shembull për gjeneralin që është përkthyer në atë kohë mbi 35 gjuhë tash mbi 50 gjuhë botërore thoshin, “Profesor s’po kuptojmë bash mirë por po kuptojmë jetën e ni italianin që shkon te populli gjerman”. Unë atëherë ndalesha dhe ju sqaroja. Thoja, “Shikoni, Kadare flet pak e ka mendime shumë. Që ne i thomi si figurë stilistike elitike ose elipsa”. U ndalsha vetëm në katër fjalët e tij, “Korba ti moj Nicë, mjera ti moj Nicë, qyqja ti moj Nicë”. Nxanësit vetëm hamendeshin si. Ju thojsha, “Kush po i kërkon ata gjeneralët?” Ata e dinin që gjenerali dhe prifti. “Po pse ndodhi ajo?” Kulminacioni i veprës. Ata e kuptonin ma mirë kur unë u sqaroja.

Ju thojsha, “Gjenerali shkon për t’i kërkuar eshtrat e ushtarëve të tij të vvarë. Në ni dasmë ni plakë që ishte në kand të dhomës kur e sheh edhe priftin që po hidhet në valle i kujtohet që në pragu ne shtëpisë që ia kishin dhunu vajzën dhe hudhur në pus dhe e ka vorros te pranë i shtëpisë”. E përshkruan erën, saherë që dilja jashtë, saherë që hyja i dëgjoja si kërsima të vajzës. Ajo e merr kulminacionin, fillon me qajtë, shkon në shtëpi. Kur kthehet ju thotë, merreni ua solla. Kadare e përshkruan se ishte ni motiv i vështirë etj. Ato simbole a i kuptoni kur edhe mësimdhanësi ua sqaron. Këtë po e përmendi se në vite të ‘80-ta këta e kishin literaturë edhe nxënësit serb që ishte e përkthyer në gjuhen serbe nga poeti e akademiku Esat Mekuli. Ata lexojshin vetëm temat e dashurisë.

Unë atëherë kom dalë dhe ju kom sqaru, “Nëse doni ta prishni moralin e ni kombi, t’ni populli atë e gjeni te Kadare”. Te Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur ku përshkruhet në moral hapja e shtëpive publike. Për herë të parë në letërsinë tonë kombëtare përshkruhet rasti. Këtë po ua përmendi edhe juve që ta keni në këtë intervistë. Ni i ri shqiptar që ishte fejuar shkon në shtëpi publike. Baba i tij kthehet me dilemë thotë, “Qy çka vepron djali im”. Për herë të parë në kombin tonë e kemi të shkruar si baba vret djalin. Të thitë çuditën si osht’ e mundur baba ta vret djalin. Thotë, “Po e vraj që t’mos dëgjojnë të tjerët as mos të hapet shtëpitë publike por edhe të dijnë të tjerët që fjala e dhënë besa duhet të mbahet”.

Këtë nuk e hasim në literaturë në vepra të tjera. Ndoshta kjo osht’ vlera ma e madhe e Kadaresë që fatkeqësisht u nominu disa herë dhe kurrë s’e mori çmimin nobel. Këtë po e përmendi se kohëve të

fundit lexohet po shumë pak, që të thom ni përqindje e vogël. Vitet '90-ta kur kishim Revistën Pedagogjike Shkëndija, shkruja mendime pedagogjike në mesin e tyre sa lexon nxanësi ynë. Por nganjëherë pyesja vetën, jo vetëm nxënësin, sa lexon mësuesi ynë. Shkëndija ishte ni revistë pedagogjike që e botonte enti i teksteve mësimore. E pagunte bashkësia e kulturës e shpërndante falas nëpër shkolla dhe e shihshe që as mësuesit tonë s'e lexonin sa duhet. E shihsha me atë ndeznin stufat që është ni turp i madh. Edhe sot i mungon spektri pedagogjik. Duhet të jetë ndonjë revistë arsimore që ta lexojnë mësuesit tanë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Keni punu ni kohë në Prishtinë po pastaj...

Selim Krasniqi: Në Fushë Kosovë, nga viti '80-të, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë dallimi prej shkollës fillore me ni shkollë të mesme?

Selim Krasniqi: Në Elena Gjika kam punu krejt katër muj dhe meniherë kam kalu në shkollën e mesme. Po shikoni, në shkollën fillore ne çka kishim të mbaruar fakultetin ka qenë pak ma vështirë se s'ishim të përgaditur për nivelin e fëmijëve të klasës gjashtë, shtatë, tetë. Tashi shkollën e mesme është ni lehtësi e madhe për mësuesit. Po e thom për mësuesit sepse ata që marrin fakultet marrin tituj mësues, arsimtar e profesor. Por unë po përmend titullin mësues që është titulli ma i mirë, ma i shejtë. Profesori Beqa na thotë, "Koleg të respektuar, ju kisha këshilluar që profesioni i mësuesit është mision, nuk emision po mision. Është mision i shenjtë. Sepse ju jeni ata që të tjerët do t'i ngrisni dhe do të mësojnë si duhet".

Shpesh herë na pyesin për vitet 2000 pas luftës kur filloj testi PISA. 'Jo ne e morëm vendin e fundit, jo të parafundit. Jo nuk dijmë lexim'. Osh' e vërtetë që kemi marrë vendin e parafundit. Unë kam marrë pjesë vet në vitin 2015, po ata që i përpilojnë pyetjet ata s'kanë ndonjë gabim. Sepse për shembull në Japoni fëmiju mëson deri në klasën e gjashtë etikën. Kurse ne fillojmë nga mosha gjashtë vjeçare. Pytjet kanë qenë të pakapshme. Atë e kom thanë edhe në emisionet e tjera dhe shkrimet që i kam bërë. Për shembull binte pyetje në atë kohë vaksinimi. Po ku mund ta dijë nxanësi nga periferia nga fshati kur bohen vaksinimet, cilën moshë fillojnë. Fertiliteti, infertiliteti. Që janë provime vetëm për studentët e mjekësisë. Ose të tjera.

Kurse tash shembull po e marrim shkollën finlandeze që është. Nxanësit e kanë landë të veçantë si të përgadisen si të gjinden për jetë. Ne e kishim në vite të '70-ta landën e amvisnisë po mësuesit tonë as s'na kanë mësuar për atë. Po fundi ishte sikur landa e batit që të mbarojnë diçka nga druri, nga metali dhe i shtishin në punë prindërit që t'na punojnë. Derisa nuk fillojmë n'atë formë është e pamundur që të arrijmë sukses. Osh' thuhet leximi. Nuk po lexojnë. Me lexu dijnë të gjithë por sa kuptojnë. Aty janë

fajtor organet shtetërore që duhet të ndrohen planet mësimore. Jo sikur deri tash. Të kenë më pak lëndë e jo nxënësit të jenë si harmonikë, të hapen si harmonika.

Planet do të jenë pak më të thjeshta, nxënësit do të jenë më të lirë, do të mësohet më tepër mësimi kreativ. Fëmijët vet të gjykojnë për punën që e bëjnë. Ose nga lënda e matematikës. Matematika logjike do të punohet si duhet. Mësuesit janë shumë të pregaditur. Nxënësit janë të pregaditur. Por, duhet me ni përkushtim që me siguri në të ardhmen do të bëhet dhe të shikohen planet e tjera. Ne s'mund të shikojmë planet finlandeze po duhet të shikojmë nga rajoni. Në mesin e rajonit shkolla tona janë mjaft të mira në krahasim, ndoshta edhe me të tjerat pavarësisht cilin vend e marrin.

Anita Susuri: Deshta me u kyç me bisedu pak për vitet kur keni qenë në gjimnaz dhe ka fillu sistemi paralele, siç osht' qujtë. A ju kujtohet dita kur policia ka ardhë ose a ka ardhë policia? Si ka ndodhë kjo që ju kanë largu?

Selim Krasniqi: Po nga viti 1989 me heqjen e kushtetutës të Republikës së Kosovës veç kanë filluar përpjekjet e para që ne të largohemi nga shkolla. E sidomos që janë ndrru planet në gjuhë shqipe, në letërsinë shqipe, në art figurativ dhe në histori. Atëherë ne shoqata e gjuhëtarëve në Institutin Albanologjik kemi mbajtë ni mbledhje dhe kemi caktuar hartuesit e planeve mësimore. Për shkollat e mesme kam qenë unë. Për universitet në fushën e gjuhës ka qenë Profesori Shaqir Berani. Në fushën e letërsisë Profesor Rexhep Qosja. Kemi fillu t'i punojmë ato plane dhe nga viti '90-të veç pothuajse filluan largimet e para.

Për herë të parë largimet janë bërë në vitin 1991. Së pari në gjimnazin e Fushë Kosovës. Ni paralele që kishte fillu vitin e parë veç na larguan nga mësimi dhe shkum në Lagjen e Zogajve që ma vonë e kemi përgëzuar me emrin Shkolla Shqipe. Pastaj nga viti '91 veç filluan të gjitha shkollat e komunës së Fushë Kosovës. Ku kanë pasë nxanës në Lagjen e Grajçevcëve, në Lagjen e Merovcve, në fshatin Akër, te Kelmendt. Po edhe në pjesë të tjera. T'ju përmendi çfarë në atë kohë? Vështirësi ma të mdha kanë pasur shkollat e mesme sepse fëmijët e rritur 17-18 vjeçar janë detyruar t'i kalojnë tri apo katër palë shtëpi ku kanë qenë familjet serbe. Pastaj policët.

Sidomos, tetë vjet ka punuar gjimnazi ynë në shkollën e Lismirit. Sidomos hekurudhën të kalohen binarët e trenit ka qenë e pamundur që çdo natë ndonjë nxanës të mos frikësohet apo të rrahet nga policët e asaj kohe, milicia serbe. Fatmirësisht prindërit e kanë kontribuar mjaft. Ne pa ndihmën e tyre asgjë s'kishim mujtë të arrijmë as atëherë as sot. Ata na kanë dërgu fëmijët në shkollë dhe kanë thanë, "Fëmijët janë të jujt. Ju kujdesuni në shkollë ku jeni. Për rrugë ju s'mund të i përcillni", se kishim së paku 400 nxanës. 400 nxanës me pesë arsimtar nuk mund të përcilleshin.

Ato kanë qenë vitet ma të vështira. Por fatmirësisht në shtëpi shkolla ku kemi punu, nxënësit janë përpjekë që edhe ato dhoma t'vogla të ngushta të ulen mbi ndonjë tepih me ndonjë bllok apo ndonjë dru që uleshin. Drrasa që i vënin në vend të tabelave. Kanë qenë jashtëzakonisht të rregulltë dhe kanë

punuar mjaft. Secili prej tyre ka arritë, që kemi mjaftë intelektual sot që punojnë në Universitetin e Prishtinës po edhe jashtë.

Anita Susuri: Po m'intereson qajo organizimi si ka ndodhë? A keni marrë pjesë? A keni shku në familje apo kanë ardhë ata vet?

Selim Krasniqi: Organizimin e kanë bërë atëherë partitë politike e kanë bo. Kurse ne si mësues vetëm e kemi pasë obligim që t'shkojmë t'i mbajmë orët, të organizojmë nxanësat, të mbajmë mbledhje me nxanësa. Ato i kanë kry veprimtarët e komunës së Fushë Kosovës. Unë do t'ju përmendi në atë kohë se neve në Lismir na ka ndihmuar mjaftë familja e Ibush Gojnovcit, ku të gjithëve mësuesve të gjimnazit na ka paguar pagesat për gjashtë muaj. Për tërë komunën e Fushë Kosovës ka qenë një nga Bardhi i Madh me emrin Sylë Gërguri. I cili për ni vjet ka paguar nga 40-50 euro për të gjithë 400 mësime të Fushë Kosovës. Që ka dhanë ni kontribut mjaft të madh.

Unë shpesh herë u thosha nxanësve, maturantëve, sidomos mas luftës, "Shikoni se në mesin e juv keni ata që janë kujdes për ne që kanë paguar për ne. Fundja populli është kujdes për ne". Ai 3% është dhënë për ne, të ardhurat i kemi marrë nga ata. Ne s'duhet të harrojmë vitin '93 punëtorët që punonin nën regjimin e Serbisë. Ata s'kanë pasur të ardhura ma shumë se dy apo tri euro të sotshme apo dy-tri marak të viteve '90-të sepse ishte inflacioni në Jugosllavi. Ne aq sa kanë mundur na kanë pagu populli dhe për atë jemi shpërblyer. Shpërblymi ma i madh osht' kur shkon populli dhe thotë ky osht' mësuesi i popullit. Ne kemi qenë mesues të popullit. Unë i quaj prindërit dhe nxënësit hero të viteve '90-ta.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe qysh ka qenë për shembull gjendja e nxënësve? Sa kanë qenë ata të pregaditur ose të gatshëm për me bo mësimin jashtë shkollave?

Selim Krasniqi: Në atë kohë kur filloj shtëpitë shkolla së pari në Fushë Kosovë pastaj në tërë Republikën e Kosovës ka ndihmu edhe Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë Naim Frashëri. Nxënësit kanë qenë të bindur dhe ne kemi menduar që sidomos maturantët 18-19 vjeçar mos të ishin ardhë në shkollë atëherë ishin marrë me vepra të tjera. Kishin dalë edhe jashtë. Ne i kemi mbajtur brenda. Ajo ka qenë merita më e madhe e mësuesve tanë, prindve tanë, qytetarëve tanë. Kanë qenë të përgaditur. Kanë lexuar në shtëpi, ndoshta ma shumë sesa kur ishim në shkolla. Ma shumë sesa pas luftës dhe filluan rindërtimin e shkollave. Filluam edhe disa mjete t'i kemi. Atëherë është punuar mjaft. Ndoshta ideali i ka mbajtur më shumë që kanë punuar sesa sot.

Anita Susuri: A ka pasë probleme për shembull ose diçka?

Selim Krasniqi: Po nuk ka pasë ditë që nxanësit tonë, sidomos maturantët, që s'janë ndalë, s'janë malltretu. Po ata s'kanë tregu n'shollë, s'ju kanë tregu as shokve e shoqeve t'veta vetëm ata dy-tre që e kanë ditë. As prindërve se e kanë ditë që t'nesërmen s'do t'vijne ma në shkollë dhe nga frika s'do të vazhdonin mësimin. Shumë lehtë nuk ka qenë për ne. Ne e dinim për shembull vujtjet e tyne. Mësimi

kur osht' mbajtë në Fushë Kosovë që ka qenë shtabi i ashtu quajtur i revolucionit të atyre viteve të '90-ta, mësimi është mbajtë i rregulltë. Në fletore tona, në ditarët tonë që kemi pasur nuk ka pasur mungesa gati fare. Sepse ne i kemi evidentuar për të ditur çka po ndodhë. Nëse është vonu dhjetë minuta, ka ardhë. Për këtë arsye thom që kjo është ni meritë jashtëzakonisht e madhe.

Anita Susuri: E gjimnazi juj sa shtëpi ka qenë i shpërndarë?

Selim Krasniqi: Gjimnazi ynë ka qenë vetëm në tri shtëpi në Lagjen Zogaj, në tri shtëpi. Njërin e kemi pasë sallën e arsimtarëve dhe në tri shtëpi të tjera e kemi pasë paralelet tona. Kah 40-50 në klasë. Por, dame nuk kanë shkaktuar. Mund t'ju përmendi qata që i kanë lëshu shtëpitë kanë pasur vetëm qat' dhomë t'fjetjes edhe ni dhomë të ndejes. Qata e kemi zanë na. Kjo është një punë e madhe. Atë nuk do ta bënte askush tjetër përveç popullit tonë që është bujar, fisnik.

Anita Susuri: A mundeni edhe me na përshkru si e keni përshtatë një dhomë të ndejes për shembull me bo klasë?

Selim Krasniqi: Po shiko, na, po tregoj për aty ku kom punu vet në shkollë të mesme. Ka qenë i shtruar ni tepih i thjeshtë. Në atë tepih kemi marrë ndonjë bllok dhe kemi vu ndonjë pjesë të tepihut. Nxaësit i kanë marrë vet. Ashtu janë ulë. Diçka tjetër s'ka pasë. Nga një stufë që pronarët e shtëpive e kanë vë dhe janë kujdes për të. Po përmendi ni rast të kolegut tim që e lshonte tash punon profesor Shemsedin Zogaj. Ai punonte për ne, na i ndezte edhe që vet ishte profesor në gjimnazin e Drenasit. Nxaësit mendonin që është punëtor apo shërbëtor aty.

S'ju kemi tregu derisa e kanë mbaruar shkollën e mesme. Aty s'ka pasë ndonjë ndryshim a është prind a është mësues apo dikush tjetër. Nëse ni mësimdhënës i yni është vonue në dy shtëpi që i kemi pasë e kanë zëvendësu derisa kanë ardhë. Por, nuk u ka tregu që është i asaj lande po veç po majmë derisa vjen kolegu.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë për libra?

Selim Krasniqi: Po libra kryesisht atëherë prodhimet e Rilindjes veç janë kanë në Lipjan. Fmitë i kanë përcjellë te njëri tjetri gjeneratë pas gjenerate. Ne jemi detyru, mësimdhënësit, t'ju diktojmë që është e ndalune diktimi por jemi detyru. E kanë përcjellë viti i katërt ju ka përcjellë vitit të tretë dhe kshtu me radhë. Për shkollat fillore nuk di pasiqë s'kam punuar n'atë kohë po ato kryesisht kanë punuar në shtëpinë e Skender Zogajt që kanë qenë diku tetë apo nënë paralele me dy ndrrime, tri.

Anita Susuri: Disa vende shkollat fillore kanë shku, kanë mbetë në institucione.

Selim Krasniqi: Në komunën e Fushë Kosovës asnji. Në komunën e Fushë Kosovës asnji. Përjashtim bëjnë që nga viti '92 na shkolla e mesme kemi shku në Lismir ku atje s'ka pasë serb fare. Nga Fushë

Kosova deri atje është afër shtatë kilometra. Mësuesit tonë nga kryqi deri atje s'paku 40 minuta kanë kamë bo për me ecë. Po ka qenë punkti kryesor te hekurudha. Qysh m'i kalu binarët se aty kanë qenë policia serbe.

Anita Susuri: E pse ka ndodhë kjo që në Fushë Kosovë ka pasë shumë popullsi serbe...

Selim Krasniqi: Po ka pasë shumë popullsi serbe edhe shtabi nacionalist shovinist ka qenë pikërisht në Fushë Kosovë. Shpërbërja e Jugosllavisë është bërë nga Fushë Kosova.

Anita Susuri: E do mitingje që kanë ndodhë diçka, qysh kanë ndiku te populli? Te ju?

Selim Krasniqi: Përkundrazi nxanësit i ka bashku edhe ma shumë. Aty ndoshta është edhe lidhja mes nxanësit, prindit edhe mësuesit ma e madhe. Ata e kanë kuptu dhe nuk janë frikësu. E kanë mundur frikën. Frika nuk ka ekzistuar.

Anita Susuri: Sa ju ka ra për shembull mrena ditës me i mbajtë të gjitha orët?

Selim Krasniqi: Orët nuk kanë qenë të shkurtune. Orari pothuajse ka qenë i njejtë sikurse në shkolla sot. Por ju kemi lanë bije fjala brenda ditës të mbahen gjashtë orë me orar. Po kryesisht atëherë i kemi nda që brenda ditës t'i kemi një ditë landët shoqërore, ditën tjetër të shkencave natyrore fizik, kimi, biologji. Për arsye që edhe t'jenë nxënësit ma të lirë edhe mësime të përgaditen dhe mos t'kenë nevojë me ndrru shumë. Se prej shtëpije në shtëpi ishin 20 apo 30 metra. Për gjimnaz 20-30 metra dhe që ishin në të njejtën lagje. Për këtë arsye që mos me pasë pushim.

Pushim nuk u kemi dhanë nxënësve sepse po të kishte pushim aty ishte lagje. Për nxanës ka qenë pakëz ma vështirë kurse për ne jo. E kishim orarin dhe shkonim në orar pesë minuta vazhdonte ma tutje në klasën tjetër. Nshanësit i lejshim në ato paralele.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë me i rujtë ditarët edhe dokumentacionin?

Selim Krasniqi: Po dokumentacionin ne e kemi rujtë se e kemi mbajtë vet. Nëpër ato shtëpia e kemi pasë ma lehtë. A në vite të '90-ta kur ka mbetë në shkollë e kanë rujtë administrata. Atëherë ka qenë nga Ministria e Arsimit që punëtorët e administratës që kanë punue edhe me regjimin e atëhershëm t'na rujnë aq sa munden. Po kryesisht kanë humbur të viteve të '90-ta. Kemi pasë pak raste që pas luftës kanë ardhë me kërkunë ne i kemi pasë ditarët tonë secili, fletorët tona shënimet. Kur janë rujtë dhe e kemi ditë për ata nxanës dhe ju kemi lëshu deftesa vetëm atyre që kanë qenë të rregulltë.

Anita Susuri: Deri kur ka vazhdu, deri '99-ten apo...

Selim Krasniqi: Deri me 22 mars. Bombardimet kanë fillu me 24. Shkollat në komunën e Fushë Kosovës kanë punu deri me 21 apo 22 mars. Deri të premtën. Ato kanë qenë shumë ditë të vështira. Përpiqeshim nxënësve t’mos t’ju tregonim që po ndodhë ajo. Unë kam qenë atë ditë në mësim, në Lismir. Përgaditeshim sepse e kishim ditën e shkollës me 5 mars. Atë ditë dëgjonim betonimet nga Prekazi. Unë jam vonu atë ditë sepse udhëtoja pakëz ma larg nga pjesa e Drenicës t’vij deri këtu. Po përmendet që, “Si mësues ose si arsimtar ka qenë dashtë të vini nga ora tetë ose nantë se kemi programin”.

Me heshtje s’po i tregoj atij se dëgjojnë nxanësit. E thirra ata, e thirra drejtorin dhe ju thashë, “Unë jam vonu sepse aty ka luftë. Pjesa e Prekazit ka luftë. Unë kam ardhë nga pjesa e Lipjanit, Magures mezi që arrita deri këtu. Ka luftë”. Ju thashë, “Programit ne s’do ta mbajmë me 5 mars. Do ta këndojmë vetëm marshin e UÇK-së dhe lironi nxanësit që t’shkojnë në shtëpi”. Pra, është punuar. Por edhe ata filluan ta marrin vetën se Fushë Kosova katunet Harilaç pjesa e Sllatinës, ata e kanë pasë afër kufi me Drenicë dhe kanë ditë që është luftë. Kurse Fushë Kosovë dhe Prishtinë është punuar. Në Fushë Kosovë është punuar deri atë datë që u përmenda.

Anita Susuri: E pastaj kur kanë fillu bombardimet keni qenë ende këtu në Fushë Kosovë apo?

Selim Krasniqi: Në Fushë Kosovë kemi qenë shumica. Në Prishtinë kam banu në atë kohë. Fushë Kosovë kush ka qenë e pamundur me dalë, vetëm livadheve dhe fushave me arritë deri në Prishtinë. Nga 24 marsi ma... 21 marsi nuk osht’ punu në Fushë Kosovë deri jemi kthyer nga lufta. Kshuqë mësimet i kemi filluar diku ka shtatori. Nga viti ‘98-’99 unë kam punuar si gazetar i rregulltë në gazetën Kosova Sot. Për çdo ditë kam pasur shënime për komunën e Fushë Kosovës. Mësimin, arratisjet e të gjitha. Saqë niherë ni koleg i imi pyt, “Po t’i pashë inicialet e tua diku?” “Jo, jo s’mi ke pa askund. Mos fol”.

Kam punuar kam përcjellë. Nuk kam përcjellë vetëm nga data 1 prill deri më 28 qershor. Atëherë kom filluar prap. Kam punuar në Agjencinë e Lajmeve Kosova Press dhe në Gazetën Rilindja për komunën e Fushë Kosovës. Bile shumica e të gjeturave që janë prej komunës së Fushë Kosovës janë gjetur përmes shkrimeve elektronike që i kemi bërë nga Agjencia e Lajmeve Kosova Press. Sidomos familja Behluli, po edhe të tjerët. Kem bashkëpunu në atë kohë me Sheh Idrizin që ka qenë kryetar i Këshillit për të Zhdukur për komunën e Fushë Kosovës. Kemi mbajtur shënime të mjaftueshme sidomos në varrezat në Mes Bardh, Pomozotin, në Vragoli. Fatkeqësisht ende ka edhe shumë të zhdukur.

Anita Susuri: Pastaj në këtë periudhë që thatë nuk keni punu. A keni dalë jashtë në Maqedoni apo?

Selim Krasniqi: Kam qenë afër dy muj në Maqedoni në Gostivar.

Anita Susuri: A ju ka ra juve kjo në Bllacë me qëndru?

Selim Krasniqi: Vetëm ni natë. Vetëm ni natë.

Anita Susuri: Pas luftës a keni punu edhe ni kohë për domethanë për me identifiku...

Selim Krasniqi: Pas luftës tri vjet, katër edhe ma shumë kemi punu derisa janë ndërpre. Deri osht' ndërpre Rilindja kom punu vazhdimisht.

Anita Susuri: Edhe njëkohësisht si mësimdhënës edhe si...

Selim Krasniqi: Mësimdhënës edhe në Gazeta Rilindja edhe në Agjencinë e Lajmeve Kosova Press. Deri me mbylljen e Rilindjes.

Anita Susuri: E në çfarë gjendje keni gjetë shkollat kur jeni kthy?

Selim Krasniqi: Po pas kthimit të luftës ka qenë ni mjerim i madh në Fushë Kosovë. Shumica e banorëve me shtëpi të djegura. Mbi 1600 të zhdukur. Po edhe në ato kushte kemi filluar të punojmë. Ne lokalim tonë që e kishim në Bresje, gjimnazin, as nuk e kanë leju. Kemi bërë disa tentime as që është leju. Kemi fillu ni aneks të Shkollës Fillore Selman Riza dhe pas disa vitesh osht' ndërto edhe gjimnazi i ri që është edhe sot.

Anita Susuri: A ka qenë vështirë krejt kjo punë me u bo?

Selim Krasniqi: Po jashtëzakonisht ka qenë e vështirë po duhet me përmend në atë kohë të gjithë bashkëpunëtorët e partive politike që kanë bashkëpunu mes veti, qeverisë së përkohshme. Po edhe në të ardhmen që ka qenë pakëz ma lehtë kur filloj ndërtimi i shkollave, rindërtimi i tyre. Po edhe sot komuna e Fushë Kosovës ka shumë nxënës, ka shumë banor, ka klasa. Vetëm në gjimnaz gjithmonë kemi pasë deri 50 nxanës ni klasë. Që mesatarja do të jetë përpara ishte 21.4 nxanës mësuesi që kish. Komuna e Fushë Kosovës edhe sot ka mbi 30 nxanës. Do të thotë që nuk ka rënë. Në fshatra ndoshta po por mesatarja është kaq numri. Edhe sot edhe para pesë vjetësh.

Anita Susuri: Ju thatë që në vitin 2020 jeni pensionu. A mundeni për shembull me na bo ni krahasim viteve para viteve '90-ta, vitet '90-ta vitet pas luftës si ka qenë arsimit? Domethanë ju si e keni pa? Qysh ka ndryshu? Cila ka qenë periudha ma e vështirë?

Selim Krasniqi: Po periudha ma e vështirë ka qenë periudha nga viti '81 deri në vitin '90. Sepse kemi qenë të përcjellun hap pas hapi. Me ndryshimin e plan programeve. Nga vitet '90-të që kemi qenë në shtëpi shkolla ne kemi qenë t'libër edhe t'drejtë të punojmë. Pas luftës ka qenë puna ma e lehtë që të punohet. Sepse kemi qenë të libër por unë jam largu nga ajo që t'largohemi nga temat e luftës që nxanësit ni pjesë e madhe kanë pasur të zhdukur në familje, të tjerë që kanë qenë dhjetë apo 15 vjeçar

ende i kanë pasur pa shlyer ato kufoma. Kryesisht përpiqeshim nëpër mësimin modern dhe jo t'jepen tema nga lufta që t'ju rikujtojmë edhe niherë. Sot osht' shumë ma lehtë.

Por fatmirësisht fmitë e atyre viteve tash i kanë kalu 20-tat kanë mbaru studimet, punojnë. Kjo është knaqësia ma e madhe sepse ne jemi njerëzit ma të pasur mësimdhënësit sepse ish nxanësit tanë, studentët tanë i kemi edhe pilot edhe inxhinier edhe mjek edhe të lamive të tjera.

Anita Susuri: Zoti Selim ju falënderoj shumë për intervistën edhe kohën!

Selim Krasniqi: Faleminderit!